





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në bazë të nenit 3, paragrafi 2, pikë 6 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave Nr 04/L-44, nxjerr këtë:




VENDIM

**PEZULLOHET PROCESI I PLOTËSIMIT-NDRYSHIMIT TË KODI I ETIKËS PËR
OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS**

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), bazuar në nenin 8 të Ligjit të KPM-së Nr 04/L-44, me datën 9 dhjetor 2019, ka shpallur për diskutim publik Draft-Kodin e Etikes për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele.
2. Gjatë periudhës së diskutimit publik, palët e interesit kanë paraqitur komentet përmes të cilave kanë shprehur shqetësimet e tyre në raport me disa dispozita të këtij akti, duke pretenduar së me propozim-ndryshimet e reja të Kodit mund të pengohet puna e mediave.
3. KPM, ka analizuar komentet e palëve të interesit dhe në mënyrë që këto komente të analizohen dhe propozim ndryshimet e reja të ri-vlerësohen, vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim mbetet në fuqi deri në një vendim tjetër të KPM-së.

Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.


Muja FERATI
Kryetar



11.02.2020
Datë